

SKEDË INFORMIMI

Mundësi për aplikim të bashkive në thirrjen me 5 prioritete “CERV-2026-DAPHNE” nën Programin CERV

Synimi i Thirrjes:

Thirrja synon të parandalojë dhe luftojë dhunën me bazë gjinore, dhunën ndaj grave dhe vajzave, dhunën në familje dhe të gjitha format e dhunës ndaj fëmijëve. Ajo mbështet përmirësimin e shërbimeve për viktimat, parandalimin e dhunës online dhe offline, forcimin e kapaciteteve të institucioneve publike dhe krijimin e sistemeve të koordinuara për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave.

Fushat e veprimit të thirrjes:

Prioriteti 1, me kodin CERV-2026-DAPHNE-REGRANTING, synon të mbështesë organizata ose institucione që do të administrojnë dhënien e nën-granteve për organizata të vogla të shoqërisë civile. Prioritet do t’u jepet subjekteve që punojnë në zona rurale ose të largëta dhe që kanë akses të kufizuar në burime financiare. Projektet mund të trajtojnë dhunën në familje, dhunën seksuale, dhunën kibernetike, përndjekjen dhe ngacmimin online, shpërndarjen pa pëlqim të materialeve intime, martesat e detyruara, praktikat e dëmshme, dhunën ndaj fëmijëve, bullizmin dhe neglizhencën. Përveç nën-granteve, aplikanti duhet të realizojë një program të strukturuar për ngritjen e kapaciteteve të OSHC-ve përfituese.

Prioriteti 2, me kodin CERV-2026-DAPHNE-PROTECTION, fokusohet te mbrojtja dhe mbështetja e viktimave dhe të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore. Bashkitë mund të propozojnë krijimin ose përshtatjen e qendrave të integruara “one-stop-shop”, ku viktimat të marrin në mënyrë të koordinuar mbështetje sociale, psikologjike, shëndetësore, ligjore dhe institucionale. Mund të financohen gjithashtu qendra për viktimat e dhunës seksuale, mekanizma për vlerësimin e rrezikut, masa për parandalimin e femicidit, protokolle për reagim të menjëhershëm dhe shërbime të posaçme për gratë rurale, personat me aftësi të kufizuara, migrantet, minoritetet dhe grupet e tjera vulnerabël.

Prioriteti 3, me kodin CERV-2026-DAPHNE-PREVENTION, synon parandalimin e dhunës me bazë gjinore përpara se ajo të ndodhë. Projektet mund të përqendrohen te parandalimi i përdhunimit dhe promovimi i rolit qendror të pëlqimit në marrëdhëniet seksuale, përfshirja e burrave dhe djemve në programe parandaluese, rritja e sigurisë digjitale dhe parandalimi i dhunës kibernetike ndaj grave dhe vajzave. Mund të zhvillohen gjithashtu mekanizma për raportimin dhe heqjen e përmbajtjeve të dhunshme online, programe për autorët e dhunës me qëllim parandalimin e përsëritjes së saj, si dhe masa kundër stereotipeve gjinore dhe ngacmimit seksual në media dhe sektorin audioviziv.

Prioriteti 4, me kodin CERV-2026-DAPHNE-CONVENTION-DIR, mbështet zbatimin e Konventës së Stambollit dhe Direktivës së BE-së për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Ky prioritet fokusohet në ngritjen e kapaciteteve të autoriteteve publike dhe profesionistëve që punojnë me viktimat ose autorët e dhunës. Bashkitë mund të propozojnë trajnime për punonjësit socialë, policinë, personelin shëndetësor, mësuesit, gjyqtarët, avokatët dhe personelin e gjykatave. Trajnimet duhet të përmirësojnë aftësinë për identifikimin, parandalimin, referimin dhe trajtimin e rasteve në mënyrë të ndjeshme ndaj traumës, gjinisë dhe fëmijëve. Ky është prioriteti ku bashkia ka rolin më të drejtpërdrejtë, pasi aplikanti i vetëm ose drejtuesi i konsorciumit duhet të jetë autoritet publik.

Prioriteti 5, me kodin CERV-2026-DAPHNE-CHILDREN, synon forcimin e sistemeve të integruara të mbrojtjes së fëmijëve. Projektet duhet të krijojnë bashkëpunim të qëndrueshëm ndërmjet bashkive, shkollave, policisë, institucioneve të drejtësisë, shërbimeve sociale, sistemit shëndetësor, OSHC-ve dhe vetë fëmijëve. Mund të trajtohen parandalimi i dhunës, bullizmit dhe cyberbullying, identifikimi i hershëm i rasteve, krijimi i mekanizmave miqësorë të raportimit, hartimi i protokolleve të përbashkëta të referimit dhe ofrimi i mbështetjes psikologjike, sociale, ligjore, mjekësore dhe arsimore. Pjesëmarrja e një autoriteti publik është e detyrueshme në këtë prioritet.

Kush mund të aplikojë dhe çfarë konsorciumi pranohet:

Në Prioritetin 1 mund të aplikojë një subjekt i vetëm ose një konsorcium. Bashkia mund të marrë rolin e partnerit kryesorë ose të koordinatorit, me kusht që të dëshmojë kapacitet të mjaftueshëm administrativ, financiar dhe teknik për organizimin e thirrjeve të nën-grantimit, përzgjedhjen e OSHC-ve, monitorimin e projekteve dhe menaxhimin e fondeve.

Në Prioritetet 2 dhe 3 kërkohet një konsorcium me të paktën dy aplikantë përfitues. Bashkia mund të jetë koordinatore ose partnere, ndërsa rekomandohet përfshirja e organizatave të specializuara në mbrojtjen e viktimave, të drejtat e grave, dhunën me bazë gjinore, shërbimet sociale ose sigurinë digjitale.

Në Prioritetin 4, bashkia mund të aplikojë e vetme ose mund të drejtojë një konsorcium. Aplikanti i vetëm ose koordinatori duhet të jetë detyrimisht një autoritet publik kombëtar, rajonal ose vendor. Partnerët mund të jenë OSHC të specializuara, universitete, institucione shëndetësore, arsimore, sociale ose institucione të tjera publike.

Në Prioritetin 5 kërkohet një konsorcium me të paktën dy aplikantë përfitues dhe pjesëmarrja e një autoriteti publik është e detyrueshme. Bashkia mund të jetë koordinatore ose partnere dhe mund të bashkëpunojë me një OSHC të mbrojtjes së fëmijëve, universitet, shkollë, institucion shëndetësor, strukturë të drejtësisë ose organizatë rinore.

Një subjekt mund të paraqesë vetëm një propozim si koordinator në kuadër të gjithë thirrjes, por mund të marrë pjesë si partner në propozime të tjera pa kufizim. Partnerët e asociuar nuk llogariten për përmbushjen e kërkesës minimale për numrin e aplikantëve.

Aktivitete të pranueshme:

Thirrja financon fushata ndërgjegjësimi dhe komunikimi, aktivitete në media dhe rrjete sociale, trajnime dhe programe “train-the-trainer”, ngritje kapacitesh për autoritetet publike dhe profesionistët, hartimin e strategjive dhe planeve vendore, protokolle të referimit dhe menaxhimit të rasteve, krijimin e platformave ndërinstucionale, përmirësimin e shërbimeve për viktimat, ngritjen e qendrave të integruara, hartimin e manualeve dhe udhëzuesve, shkëmbimin e praktikave të mira, krijimin e mekanizmave të raportimit dhe sistemeve të mbledhjes së të dhënave.

Në Prioritetin 1, dhënia e nën-granteve dhe ngritja e kapaciteteve të organizatave të vogla të shoqërisë civile janë të detyrueshme. Projektet duhet të jenë praktike, të qëndrueshme dhe të synojnë ndryshime institucionale ose sistemike. Projektet që përqendrohen kryesisht te kërkimi shkencor nuk financohen.

Periudha e zbatimit të projekteve:

Prioriteti 1: 36 muaj.

Prioritetet 2, 3, 4 dhe 5: nga 12 deri në 24 muaj.

Projektet mund të jenë kombëtare ose ndërkombëtare.

Cili është buxheti i thirrjes për secilën bashki:

Buxheti i lejuar për çdo projekt është:

Prioriteti 1: nga 1,000,000 deri në 2,500,000 euro.

Prioritetet 2, 3, 4 dhe 5: nga 200,000 deri në 600,000 euro.

Si bëhet aplikimi:

Aplikimi bëhet vetëm elektronikisht në EU Funding & Tenders Portal.

Hapat kryesorë janë:

1. Përzgjedhja e njërit prej pesë prioritetëve.
2. Plotësimi online i Pjesës A me të dhënat administrative dhe buxhetin e përmbledhur.

3. Shkarkimi në Portal, plotësimi dhe ngarkimi përsëri i Pjesës B me përshkrimin teknik të projektit dhe buxhetin e detajuar në excel.
4. Plotësimi i Pjesës C me KPI.
5. Ngarkimi i CV-ve të stafit kryesor dhe dokumenteve mbështetëse.
6. Raporti i aktivitetit të vitit të kaluar të koordinatorit (institucionet publike përjashtohen nga ky detyrim. I detyrueshëm për subjektet e tjera). Për prioritetin 1, raporti i aktivitetit të vitit të kaluar të koordinatorëve dhe partnerëve, nëse është e aplikueshme (për propozimet e paraqitura nga një konsorcium).
7. Lista e projekteve të mëparshme të koordinatorit (projektet kryesore për 4 vitet e fundit) - modeli i disponueshëm në Pjesën B. Për prioritetin 1, lista e projekteve të mëparshme të koordinatorit (për propozimet e paraqitura nga një aplikant i vetëm) dhe partnerëve (për propozimet e paraqitura nga një konsorcium) janë të detyrueshme.
8. Paraqitja e politikës së mbrojtjes së fëmijëve kur projekti përfshin persona nën 18 vjeç. Bashkitë mund të shkarkojnë deklaratën e politikës së mbrojtjes së fëmijëve në Portal dhe ta ngarkojnë atë të firmosur nga Kryetari i Bashkisë. Subjektet private duhet të dërgojnë kopje të politikës së tyre.

Kur është afati i fundit:

Afati i fundit për aplikim është data: **3 nëntor 2026, ora 17:00, sipas orës së Brukselit.**

Linku i Thirrjes me 5 prioritete:

<https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/calls-for-proposals?order=DESC&pageNumber=1&pageSize=50&sortBy=startDate&isExactMatch=true&status=31094502&frameworkProgramme=43251589&callIdentifier=CERV-2026-DAPHNE>